



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:032728
Datë: 30.07.2024
Numri i dokumentit: 05998190
KPPP.nr.194/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përbarimore të kreditorit “FMT - Consulting” SH.P.K., me NUI: 810867757, me seli në Prishtinë, rruga “Tringë Smajli” nr.72-1, përfaqësuar sipas autorizimit nga Asdren Bytyqi, avokat nga Prishtina, kundër debitorit “M - Group” L.L.C., me NUI: 810142406, me seli në Graçanicë, rruga “Bohemije Hrabljaj”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.211/24 të datës 09.01.2024 të Përbaruesit Privat Eset Murati, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 30.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “M - Group” L.L.C., ANULOHET urdhri përbarimor P.nr.211/24 i datës 09.01.2024, i Përbaruesit Privat Eset Murati, dhe PËRFUNDOHET në tërësi përbarimi në këtë çështje përbarimore.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “FMT - Consulting” SH.P.K., ka lëshuar urdhrin përbarimor P.nr.211/24 të datës 09.01.2024, me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht Faturës Nr.163 të datës 04.12.2023, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij urdhri, kreditorit t’ia paguajë shumën prej 3,000.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, dhe ato të përfaqësimit në shumë prej 156.00 €, ashtu që përmbushja e detyrimit të bëhet edhe me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare në të gjitha bankat komerciale në Kosovë si dhe me regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit ashtu që të paguhet borxhi i kërkuar nga kreditori.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar se me kreditorin kanë pasur marrëveshje për bashkëpunim nga muaji Tetor 2022, për punët të cilat sipas kreditorit do të përfundonin brenda një muaji, por që të njëjtat nuk kanë përfunduar deri në muajin Shkurt 2023, për të njëjtën punë i është realizuar pagesa në shumë prej 1,500.00 €, si dhe disa pagesa për shërbimet mujore në vazhdimësi. Tutje ka shtuar se aplikimi i parë nga ana e kreditorit pranë ATK-së në emër të debitorit është bërë me datë 21.04.2023, ky aplikim me datë 05.05.2023 është refuzuar nga institucioni përkatës me arsyetimin se dokumentacioni i paraqitur ka qenë jo i saktë, punën të cilën ka pasur për obligim ta kryej kreditori, po ashtu dy aplikimet e radhës janë refuzuar për të njëjtën arsye, andaj debitori ka vendosur ta ndërpres bashkëpunimin me kreditorin dhe ka angazhuar persona të tjerë për ta përgatitur aplikimin për rimbursim. Sa i përket faturës e cila është objekt i kësaj procedure përmbartimore ka deklaruar se me datë 28.12.2023 përmes postës ka pranuar dy kopje të faturës një e dërguar nga kreditori dhe një e dërguar nga përfaqësuesi i kreditorit, të njëjtën faturë debitori e ka kundërshtuar dhe e ka kthyer mbrapsht tek kreditori së bashku me vërejtjen se e njëjta është refuzuar nga debitori. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit.

Kreditori, nuk ka parashtruar përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura me Nr.163 e datës 04.12.2023, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për*

përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - fatura në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarrim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban nënshkrimin e pranuesit e as vulën e debitorit si dhe nuk ka dëshmi se e njëjta është pranuar nga debitori në cilëndo formë.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm mbi të cilën mbështetet propozimi për përmbarrim, e mbi bazën e të cilës Përmbarruesi Privat ka lejuar përmbarrimin, nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbarruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundojë në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.194/24, datë 30.07.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.